

Lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes unike për shkak të kryerjes së punës sezonale në bazë të pëlqimit të entit për punë sezonale (neni 30. i Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punësim të huajve), duhet bashkëlidhur:

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
- pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
- dëshminë për sigurimin shëndetësor adekuat, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji thekson, se në Republikën e Sllovenisë nuk posedon sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;
- dëshminë për mjete të mjaftueshme për mbijetesë;
- vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajit gjithmonë në rastin e lutjes për lëshimin e lejes së parë, kurse në rastet tjera, nëse organi kështu kërkon;
- kontratën për punësim të nënshkruar nga ana e punëdhënësit ose kontratën e drejtës civile të nënshkruar nga ana e porositësit të punës.

Në procedurën e lëshimit të lejes unike njësia administrative dhe Enti i Republikës së Sllovenisë për punësim sipas detyrës zyrtare do ti sigurojnë të dhënat në vijim:

- mbi sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji me rastin e dëshimit të sigurimit shëndetësor thekson, se në Republikën e Sllovenisë ka sigurimin e detyruar shëndetësor;
- nga evidenca penale, evidenca e aktgjyqimeve të plotfuqishme përkatësisht aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;
- nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
- mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjyqimet e jo plotfuqishme të lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente;
- nga evidencat, të cilat i mban organi tatimor mbi detyrimet tatimore të jopaguara të skaduara dhe mbi kundërvajtjet tatimore, të cilat janë të shënuara si sekret tatimor;
- se në evidencën e personave të papunësuar nuk ka person adekuat të papunësuar;
- se porositësi i punës ose punëdhënësi është i regjistruar adekuat ose i regjistruar në regjistrin afarist për kryerjen e veprimtarisë, brenda kornizës të së cilës kryhet puna, të cilën do kryej i huaji, ose që është si bartës i ekonomisë bujqësore ose anëtarë i fermës regjistruar në regjistrin e ekonomisë bujqësore;
- se porositësi i punës ose punëdhënësi nuk është në procedurën e likuidimit ose falimentimit;
- se porositësi i punës ose punëdhënësi për të hyrat nga marrëdhënia e punës për gjashtë muajt e fundit para muajit të depozitimit të lutjes ose për kohën e afarizmit, nëse ky është më i shkurtë se gjashtë muaj, ka propozuar përlllogaritjet e tërheqjes tatimore për të hyra nga marrëdhënia e punës, nëse ka punësuar punëtorë, si dhe nuk ka të pa paguara detyrime tatimore të skaduara; se nuk është shfrytëzuar kuota, me të cilën kufizohet numri i të huajve në tregun e punës.

Informata lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale:

- të dhënat personale nga formulari për qëllim të lëshimit të lejes për qëndrim përpunohen në ujdi me nenin 93. të Ligjit për të huajit;

- organi ka të drejtë që të përfitoi edhe të dhëna tjera, nëse kjo është në interesin tuaj dhe se për këtë e keni dhënë pëlqimin ose nëse kjo është e lejuar me ligj, pëlqimin mund ta revokoni kurdoherë pranë organit;
- nëse për këtë janë plotësuar kushtet e parashkuara, keni të drejtë ndaj informimit me të dhënat tuaja personale, të drejtën ndaj përkufizimit të përpunimit dhe të drejtën ndaj kundërshtimit të përpunimit;
- keni të drejtë që të verifikoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, të shënuara në lejen për qëndrim, dhe të drejtën që të kërkonti ndryshimin e tyre ose, nëse për këtë janë të plotësuar kushtet e parashkuara, fshirjen e tyre;
- menaxhuesi i ruan të dhënat tuaja në ujdi me nenin 115. të Ligjit për të huajt;
- kontakti i personit të autorizuar të menaxhuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në Ministrinë e punëve të brendshme: posta elektronike: dpo.mnz@gov.si;
- nëse jeni të mendimit, se të dhënat tuaja po përpunohen joligjshëm, mund të ushtroni ankesë pranë Autorizuesit të informimit.